

## AKT – THEMELIMI

### I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “PREMIER REAL ESTATE” SHPK

Sot me dt. 23.02.2023 une **Albana Ymeraj**, e bija e Veledinit dhe Manushaqes, dtl. 23.02.1979, lindur ne Mallakaster dhe banuese ne Tirane, Rr. “Frosina Plaku” Pll. 51, shk. 2, ap. 7, me nr. Personal H95223114M në bazë të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ” vendosa:

#### Neni 1

Të themeloj një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike, e emërtuar “**PREMIER REAL ESTATE**” sh.p.k me ortak të vetëm Zj. Albana Ymeraj.

#### Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së derdhur në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në **Unaza e Re Tirane, Rr. “Tom Plezha”, pallati Ana Group, kati II.** Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjensi, përfaqësi, seli sekondare si dhe ti suprimojë ato.

#### Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkakut me vendim të ortakut të vetëm.

#### Neni 5

Kapitali fillestar themeltar i Shoqërisë do të jetë 100000 (njeqindmijë) lekë, kapital i cili është formuar tërësisht nga ortakut i vetëm themelues i saj.

#### Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakut.

Rritja e kapitalit të ortakut nuk është e kufizuar.

#### Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakut i vetëm i Shoqërisë.

#### Neni 8

*Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:*

- *Veprimtari ekonomike ne fushen e real estate: Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Shitje, blerje, dhenie me qera te te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, si dhe cdo transakcion tjeter ne funksion te permbushjes se objektit te veprimtarise ne fushen e real estate.*

*Ymeraj*  
23

- Hapjen e zyrave dhe degeve te tjera te pasurive te patundshme per arritjen e qellimit te subjektit, nepermjet nenshkrimet te kontratave Franchising.
- Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndertime urash dhe konstruksione metalike, hapje ndertim tunelesh, montime panelesh, ndertime rruges, asfaltme si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik si hapje kanalizimesh, ndertim ujesjellesash, etj.
- Shtrime rruges dhe riparime me beton, asfalto-beton ose me materiale te tjera te perdorura per kete qellim.
- Nxjerrja dhe perpunimi i lendeve te para te perdoruara per ndertim te te gjitha llojeve dhe veprimtari sherbimi per llogari te personave te trete.
- Prodhimi dhe tregtimi me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, import eksport i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve.
- Shitblerje trojesh dhe objektesh ndertimi.
- Kerkim , Zbulim , Shfrytezim Mineralesh si dhe tregtimi i tyre.
- Ngritje linjash telefonike, telegrafike, sherbim per transmetim te dhenash/internet.
- Tregtimi me shumice dhe me pakice i mallrave industriale, ushqimore, elektrike, konfeksione, paisje elektroshtepiake, alkolike, artikuj druri makineri e pajisje si dhe pjese kembimi te tyre.
- Tregtim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to, qeradhenie automjetesh.
- Tregtim duhan cigare, me shumice dhe pakice, import-eksport.
- Tregtim karburantesh me pakice, vajrash lubrifikante, te cdo tipi dhe lloji.
- Eksport dhe/ose import i te gjitha prodhimeve te mesiperme.
- Agjensi Turistike .
- Aktivitet ne fushen e Hotelerise dhe Turizmit , Bar, Restorant, Hotel, Resorte turistike.
- Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit me mjete te vete shoqerise dhe te te treteve.
- Sherbime furnizimi, shitblerjesh, mobilimi, pastrimi, dezinfektimi, mirembajtje dhe ndricimi te objekteve social-kulturore si: spitale, kopshte, shkolla, institucione lokale e qendrore, parqe, lulishte, ambiente sportive dhe pushimi, pyllezime.
- Kontraktimi me persona fizike dhe/ose juridike, vendas dhe/ose te huaj per gjetjen e tregjeve te shitjes per prodhimet e shoqerise.
- Cdo lloj veprimtarie tjeter e lidhur me keto te permenduara me siper te lejuara nga ligji.

#### **Neni 9**

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis palëve në mbështetje të Kodit të Punës, si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Neni 10**

Ortaku i vetëm nuk kufizohet në rritjen e kapitalit të Shoqërisë.

#### **Neni 11**

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortaku i vetëm themelues mbart rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë vetëm në nivelin e kapitalit të investuar në shoqëri.

#### **Neni 12**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim mbetet në kopetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, ku do të jetë dhe rregjistri tregtar i saj.



### Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit.

### Neni 14

Organet e shoqërisë “**PREMIER REAL ESTATE**” sh.p.k janë:

Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Zj. **Albana Ymeraj**, e cila është përfaqësuese ligjore e saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

Persa i perket aktivitetit në fusha specifike shoqëria do të ketë Drejtuesit e saj konform të gjitha kritereve ligjore.

### Neni 15

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

### Neni 16

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në **Qendrën Kombëtare të Biznesit**, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare

Tiranë më 23.02.2023.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“PREMIER REAL ESTATE” SHPK**

**ALBANA YMERAJ**

*Albana Ymeraj*  
*af 23*